



Në bazë të nenit 35, paragrafit 1, nënparagrafit 1.1, dhe nenit 65, paragrafëve 1 dhe 2, të Ligjit Nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 77/16 gusht 2010), të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 05/L-150 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.10/03 prill 2017), si dhe nenit 8 dhe nenit 110, paragrafi 5, të Ligjit Nr. 08/L-304 për Bankat (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 2/27 janar 2026), Bordi i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës në mbledhjen e mbajtur më 29 qershor 2026, miratoi këtë:

RREGULLORE PËR INSTRUMENTIN E NDARJES SË ASETVE

KAPITULLI I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi dhe fushëveprimi

1. Kjo rregullore përcakton kushtet me qëllim zbatimin e instrumentit të ndarjes së asetve në zbatim të procesit të përmbylljes së bankave.
2. Kjo rregullore zbatohet për të gjitha bankat në Republikën e Kosovës dhe institucionet urë, të licencuara nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, me përjashtim degët e bankave të huaja.

Neni 2

Përkufizimet

1. Të gjitha shprehjet e përdorura në këtë rregullore kanë përkufizimin siç përcaktohet në nenin 3 të Ligjit Nr. 08/L-304 për Bankat, dhe/ose siç përcaktohet në vijim për qëllimin e kësaj rregulloreje:
 - 1.1. **Ligji për Bankat** – nënkupton Ligji Nr. 08/L-304 për Bankat;
 - 1.2. **BQK si autoritet mbikëqyrës**- nënkupton BQK-në si autoritet mbikëqyrës ose licencues;
 - 1.3. **Subjekti** - subjekt (entitet) për menaxhim të asetve.
 - 1.4. **Ministria e financave** - nënkupton ministrinë përgjegjëse për financa në Qeverinë e Republikës së Kosovës;
 - 1.5. **Instrumenti i ndarjes së asetve** – nënkupton mekanizmin për të kryer transferimin e asetve, të drejtave ose detyrimeve të një banke në kuadër të përmbylljes tek një person juridik për menaxhimin e pasurisë në pajtueshmëri me nenin 110 të Ligjit për banka;
2. Përveç rasteve kur specifikohet ndryshe, referencat për BQK-në në këtë rregullore, interpretohen për BQK-në në cilësinë e autoritetit të përmbylljes.

KAPITULLI II

INSTRUMENTI I NDARJES SË ASETEVE

Neni 3

Kushtet për zbatimin e instrumentit të ndarjes së aseteve

1. BQK mund të zbatojë instrumentin e ndarjes së aseteve për bankat që përmbushin kushtet e zbatueshme për përmbyllje të përcaktuara në nenin 106 të Ligjit për Bankat.
2. Kur BQK vendos të zbatojë instrumentin e ndarjes së aseteve në procesin e përmbylljes së bankës dhe se veprimi i përmbylljes do të rezultojë në humbje që do të barten nga kreditorët ose ku pretendimet të tyre konvertohen, BQK-ja ushtron kompetencën për të zvogëluar vlerën dhe për të konvertuar instrumentet kapitale në përputhje me nenin 112 të Ligjit për Bankat menjëherë përpara ose së bashku me aplikimin e instrumentit të përmbylljes.
3. BQK mund të zbatojë instrumentin për ndarjen e aseteve vetëm së bashku me një instrument tjetër të përmbylljes.
4. Në rastet e zbatimit të instrumentit të shitjes së veprimtarisë tregtare dhe instrumentit të institucionit urë dhe kur BQK gjithashtu përdorë instrumentin e ndarjes së aseteve për të transferuar vetëm një pjesë të aseteve, të drejtave ose detyrimeve të bankës në proces të përmbylljes, banka e mbetur ose banka nga e cila asetet, të drejtat ose detyrimet janë transferuar, do të mbyllet sipas procedurave të rregullta të likuidimit.
 - 4.1. Mbyllja e tillë bëhet brenda një afati të arsyeshëm kohor, duke i kushtuar vëmendje çdo nevojë që banka e mbetur të ofrojë shërbime ose mbështetje në pajtim me nenin 121, paragrafi 1, nënparagrafi 1.12, të Ligjit për Bankat, në mënyrë që t'i mundësojë pranuesit të kryejë aktivitete ose shërbime të zotëruara me anë të këtij transferimi, dhe çfarëdo arsye tjetër që vazhdimësia e bankës së mbetur është e nevojshme për të arritur objektivat e përmbylljes.
5. Në pajtim me paragrafin 8 të nenit 102 të Ligjit për Bankat, BQK dhe Fondi Kombëtar i Përmbylljes mund të rimarrin çdo shpenzim të arsyeshëm të shkaktuar me përdorimin e instrumenteve dhe kompetencave të përmbylljes ose të instrumenteve të qeverisë për stabilizim financiar në një ose disa nga mënyrat e mëposhtme:
 - 5.1. si shumë e zbritshme nga çdo vlerë e paguar nga një pranues i bankës në proces të përmbylljes ose, sipas rastit, për pronarët e aksioneve ose instrumenteve të tjera të pronësisë;
 - 5.2. nga banka në proces të përmbylljes, si një kreditor i preferuar; ose
 - 5.3. nga çdo e hyrë e gjeneruar si rezultat i ndërprerjes së funksionimit të institucionit urë ose subjektit për menaxhimin e aseteve, si një kreditor i preferuar.

Neni 4

Instrumenti i ndarjes së aseteve

1. Për të zbatuar instrumentin e ndarjes së aseteve, BQK, bazuar në nenin 121 të Ligjit për Bankat, ka kompetencën të transferoj asetet, të drejtat ose detyrimet e një banke në proces të përmbylljes ose të një institucioni urë në një ose më shumë subjekte për menaxhim të aseteve. Transferimi mund të bëhet pa marrë pëlqimin e aksionarëve të bankës në proces të përmbylljes ose të ndonjë pale të tretë përveç institucionit urë dhe pa respektuar kërkesat procedurale.

2. Për qëllimet e instrumentit të ndarjes së aseteve, BQK mund themelojë subjektin për menaxhimin e aseteve, që duhet të jetë person juridik që i përmbushë të gjitha kërkesat e mëposhtme:
 - 2.1. është tërësisht ose pjesërisht në pronësi dhe kontrollohet nga një ose më shumë autoritete publike, të cilat mund të përfshijnë BQK-në si dhe kontrollohet nga BQK;
 - 2.2. është krijuar me qëllim të marrjes të disa ose më shumë aseteve, të drejtave dhe detyrimeve të një ose më shumë bankave në proces të përmbylljes apo një institucioni urë.
3. BQK mund të ushtrojë kompetencën e specifikuar në paragrafin 1 të këtij neni për transferimin e aseteve, të drejtave ose detyrimeve vetëm nëse:
 - 3.1. situata në treg për këto asete është e tillë që likuidimi i tyre gjatë procedurës së rregullt të likuidimit do të kishte një efekt negativ në tregun financiar. Për qëllime të vlerësimit nëse likuidimi i aseteve, të drejtave ose detyrimeve përkatëse në kuadër të procedurave të rregullta të likuidimit mund të ketë efekt negativ në një ose më shumë tregje financiare, BQK merr parasysh, së paku:
 - 3.1.1. madhësinë, thellësinë (ang. depth) dhe likuiditetin e tregut ose tregjeve përkatëse;
 - 3.1.2. kohën e pritshme të nevojshme për shitjen dhe madhësinë e mundshme të aseteve, të drejtave ose detyrimeve që do të likuidohen;
 - 3.1.3. rrezikun e luhatjeve të konsiderueshme të çmimeve, uljeve të çmimeve si rezultat i shitjeve të detyruara (të shpejta) ose efekteve të tjera të çrregullta në treg;
 - 3.1.4. numrin, profilin dhe kapacitetin financiar të blerësve ose investitorëve potencialë;
 - 3.1.5. shkallën e ndërlidhjes së aseteve, të drejtave ose detyrimeve përkatëse me pjesëmarrës të tjerë të tregut, përfshirë përmes kolateralit, financimit, instrumenteve derivative, marrëveshjeve të pagesave ose shlyerjes; dhe
 - 3.1.6. çdo ndikim të mundshëm në funksionet kritike, stabilitetin financiar dhe besimin në sistemin bankar.
 - 3.2. transferimi i tillë është i nevojshëm për të siguruar funksionimin e duhur të bankës në proces të përmbylljes ose të institucionit urë; ose
 - 3.3. transferimi i tillë është i nevojshëm për të maksimizuar të hyrat nga likuidimi.
4. Kur aplikohet instrumenti i ndarjes së aseteve, BQK përcakton vlerën për të cilat asetet, të drejtat dhe detyrimet transferohen te subjekti për menaxhim të aseteve, në përputhje me nenin 102 të Ligjit për Bankat dhe rregulloren përkatëse të BQK-së. Ky paragraf nuk parandalon që vlerësimi të ketë vlerën nominale ose negative.
5. Në varësi të nenit 3, paragrafi 5, nënparagrafi 5.3, të kësaj rregullore, për çdo vlerë të paguar nga subjekti për menaxhim të aseteve në lidhje me asetet, të drejtat ose detyrimet e përvetësuara direkt nga banka në proces të përmbylljes do të përfitoj banka në proces të përmbylljes. Vlera mund të paguhet në formën e borxhit të lëshuar nga subjekti për menaxhim të aseteve.
6. Kur aplikohet instrumenti i institucionit urë, subjekti për menaxhimin e aseteve pas aplikimit të instrumentit të institucionit urë, mundet të përvetësoj asete, të drejta ose detyrime nga institucioni urë.
7. BQK mund të transferoj asete, të drejtat ose detyrimet nga banka në proces të përmbylljes në një ose më shumë subjekte për menaxhim të aseteve në më shumë se një rast dhe të transferojë asete,

të drejtat ose detyrimet përsëri nga një ose më shumë subjekte për menaxhimin e aseteve të banka në proces të përmbylljes me kusht që të përmbushen kushtet e përcaktuara në paragrafin 8 të këtij neni. Banka në proces të përmbylljes është e detyruar të pranojë çdo aset, të drejtë ose detyrim të tillë.

8. BQK mund të transferojë të drejtat, asetet ose detyrimet nga subjekti për menaxhim të aseteve tek banka në proces të përmbylljes në njërin nga rrethanat në vijim:
 - 8.1. mundësia që të drejtat, asetet dhe detyrimet specifike mund të transferohen prapa, është e përcaktuar me shkrim në instrumentin me anë të së cilit është bërë transferimi;
 - 8.2. të drejtat, asetet ose detyrimet specifike në fakt nuk bëjnë pjesë në klasat, ose nuk përmbushin kushtet për transferimin e të drejtave, aseteve, ose detyrimeve të përcaktuara në instrumentin me anë të së cilit është bërë transferimi.
9. Në secilin rast të përmendur në nënparagrafët 8.1 dhe 8.2 të paragrafit 8 të këtij neni, transferimi mbrapa mund të bëhet brenda çdo periudhe, në përputhje me kushtet të përcaktuara në atë instrument për qëllimin përkatës.
10. Transferimet midis bankës në proces të përmbylljes dhe subjektit për menaxhim të aseteve i nënshtrohen masave mbrojtëse të përmendura në nenet 116 dhe 117 të Ligjit për Bankat dhe rregulloren përkatëse të BQK-së.
11. Pa paragjykuar nenet 116 dhe 117 të Ligjit për Bankat dhe rregulloret relevante të lëshuara nga BQK, aksionarët ose kreditorët e bankës në proces të përmbylljes dhe palët e tjera të treta, të cilëve, asetet, të drejtat ose detyrimet nuk janë transferuar te subjekti për menaxhimin e aseteve, nuk kanë asnjë të drejtë mbi ose në lidhje me asetet, të drejtat ose detyrimet e transferuara te subjekti për menaxhim të aseteve ose organet drejtuese apo menaxhmentin e lartë të tij.
12. Objektivat e subjektit për menaxhim të aseteve nuk krijojnë ndonjë detyrim ose përgjegjësi ndaj aksionarëve ose kreditorëve të bankës në proces të përmbylljes, dhe organet drejtuese ose menaxhmenti i lartë i subjektit për menaxhim të aseteve nuk kanë përgjegjësi ndaj aksionarëve ose kreditorëve të tillë për veprime dhe mosveprime në ushtrimin e detyrave të tyre, përveç nëse veprimi ose mosveprimi nënkupton pakujdesi serioze ose sjellje të keqe serioze në përputhje me legjislacionin vendor relevant që mund të ndikojë drejtpërdrejt në të drejtat e aksionarëve ose kreditorëve të tillë.

Neni 5

Fushëveprimi i transferimit, ndashmëria dhe tregtueshmëria

1. Para çdo transferimi, BQK-ja përcakton fushëveprimin e transferimit.
2. Kur është e mundur dhe kur lejohet në rastin konkret, fushëveprimi i transferimit mund të identifikojë, në lidhje me çdo aset, të drejtë ose detyrim që do të transferohet:
 - 2.1. të drejtat dhe detyrimet kontraktuale përkatëse;
 - 2.2. çdo kolateral, garanci, të drejtë kontraktuale, marrëveshje mbrojtëse (hedging) ose të drejta tjera;
 - 2.3. çdo varësi ligjore, financiare, operacionale ose informative relevante për menaxhimin, shërbimin, ekzekutimin ose shitjen e këtij elementi;

- 2.4. çdo shërbim të ndërlidhur, të punësuarit, regjistrat, licencat, qasjet në sisteme ose të dhëna të nevojshme për të siguruar menaxhimin efektiv të fushëveprimit të transferuar.
3. BQK siguron që fushëveprimi i transferimit të jetë në përputhje me modelin e biznesit, mandatin dhe strategjinë për përfundimin e veprimtarisë së Subjektit dhe, në masën e mundshme, të mundësojë menaxhim efikas dhe maksimizim të vlerës.
 4. Instrumenti i transferimit identifikon çdo element i cili nevojitet të mbetet te, ose të mbështetet nga, banka e mbetur ose institucioni urë, përkohësisht dhe përcakton marrëveshjet përkatëse të mbështetjes.
 5. Instrumenti i transferimit specifikon kushtet dhe procedurën për çdo rregullim të mëvonshëm të fushëveprimit të transferimit, duke përfshirë çdo rikthim transferimi në përputhje me nenin 4 të kësaj Rregulloreje.

KAPITULLI III

SUBJEKTI PËR MENAXHIM TË ASETEVE

Neni 6

Themelimi i Subjektit për menaxhimin e aseteve

1. Subjekti është person juridik, i organizuar në formën e një Shoqërie Aksionare, e cila është tërësisht ose pjesërisht në pronësi të një ose më shumë autoriteteve publike, si dhe kontrollohet nga BQK.
2. Subjekti për menaxhim të aseteve i menaxhon asetet e transferuara tek ai me qëllim të maksimizimit të vlerës së tyre përmes shitjes eventuale ose zvogëlimit gradual të vlerës.
3. Funksionimi i një subjekti për menaxhim të aseteve rregullohet duke respektuar dispozitat e mëposhtme:
 - 3.1. përmbajtja e dokumenteve themeluese të subjektit për menaxhimin e aseteve miratohet nga BQK;
 - 3.2. në varësi të strukturës së pronësisë së subjektit për menaxhimin e aseteve, BQK emëron ose miraton organin drejtues të subjektit;
 - 3.3. BQK aprovon kompensimin e anëtarëve të organit drejtues dhe përcakton përgjegjësitë e tyre të përshtatshme;
 - 3.4. BQK aprovon strategjinë dhe profilin e rrezikut të subjektit për menaxhim të aseteve..
4. Subjekti themelohet me vendim të BQK-së, bazuar në nenin 110 të Ligjit për Bankat dhe bazuar në këtë Rregullore, për të ushtruar aktivitete të përcaktuara në vendimin e BQK-së , dhe çdo ndryshimit eventuale të mëvonshëm të tij, me qëllim të arritjes së objektivave të përmbylljes të përcaktuara në nenin 100 të Ligjit për Bankat pa qenë e nevojshme të merret një licencë e veçantë sipas Ligjit për Bankat.
5. BQK, kur e vlerëson të nevojshëm përdorimin e fondeve publike, i paraqet propozimin Ministrisë së Financave, me qëllim themelimin dhe financimin e kapitalit të Subjektit, si instrument i përmbylljes.

6. BQK merr vendimin për themelimin e Subjektit, si dhe miraton statutin e tij, të cilat regjistrohen në ARBK.
7. Statuti i Subjektit përmban minimalisht:
 - 7.1. emrin dhe adresën e selisë së Subjektit për menaxhimin e aseteve;
 - 7.2. objektin e veprimtarisë;
 - 7.3. shumën e kapitalit fillestar;
 - 7.4. organet drejtuese të Subjektit;
 - 7.5. mënyrën e emërimit, numrin e anëtarëve dhe kompetencat e Bordit të Drejtorëve të Subjektit;
 - 7.6. përcaktimin e mënyrës së shpërblimit dhe të pagesës së anëtarëve të Bordit të Drejtorëve dhe të punonjësve të tjerë të Subjektit, si dhe të drejtat dhe detyrimet e tyre;
 - 7.7. organizimin e sistemit të kontrollit të brendshëm;
 - 7.8. obligimin për auditim;
 - 7.9. kohëzgjatjen e operimit të Subjektit;
 - 7.10. shpërndarjen e të hyrave nga procesi i likuidimit.

Neni 7

Veprimtaria e subjektit për menaxhimin e aseteve

1. Objekti i veprimtarisë së Subjektit është menaxhimi i aseteve, të drejtave ose i detyrimeve të transferuara pranë tij, me qëllim maksimizimin e vlerës së tyre nëpërmjet shitjes.
2. BQK përcakton rast pas rasti listën e aseteve, të drejtave dhe detyrimeve që i transferohen Subjektit.
3. Për të përmbushur objektivat dhe funksionet e Subjektit, BQK:
 - 3.1. miraton buxhetin e Subjektit;
 - 3.2. miraton strukturën e saj organizative dhe qeverisëse;
4. Për të arritur objektivat dhe qëllimet e tij, Subjekti ushtron çdo të drejtë mbi asetet, të drejtat ose detyrimet e transferuara, në përputhje me përcaktimet e Ligjit për Bankat dhe të kornizës rregullative të BQK-së, si dhe në përputhje me kërkesat e kësaj rregulloreje.
5. Për të përmbushur objektivat dhe funksionet e veprimtarisë së tij, Subjekti kryen funksionet e mëposhtme:
 - 5.1. menaxhon asetet e transferuara, me qëllim ruajtjen e vlerës së tyre, në përputhje me strategjinë e përmbylljes;
 - 5.2. ndërmerr përpjekjet më të mira për të arritur një kthim financiar kundrejt aseteve që ka në menaxhim, duke marrë në konsideratë:
 - 5.2.1. kostot për transferimin dhe menaxhimin e aseteve të bankës në proces të përmbylljes ose të institucionit urë;

- 5.2.2. shpenzimet për themelimin e Subjektit dhe fondet e pranuar me qëllim të themelimit të tij;
- 5.2.3. faktorë të tjerë që Subjekti i konsideron të rëndësishëm për arritjen e objektivave të veprimtarisë së tij;
- 5.3. merr asetet e transferuara nga banka në proces të përmbylljes ose institucionit urë, në përputhje me vendimet e BQK-së;
- 5.4. menaxhon asetet e transferuara duke përfshirë mbledhjen e interesave të kredive, principalit dhe kapitalit, si dhe sipas rastit, edhe ekzekutimin dhe menaxhimin e kolateralit nëse është e nevojshme;
- 5.5. kryen funksione të tjera, që lidhen me menaxhimin dhe shitjen e aseteve të transferuara;
- 5.6. ndërmerr të gjithë hapat e nevojshëm për të mbrojtur, për të përmirësuar ose për të likuiduar vlerën e aseteve të transferuara, ku përfshihen:
 - 5.6.1. shitja e kredive ose të portofolit të kredive, në përputhje me çmimin më të mirë të mundshëm në treg;
 - 5.6.2. sekuritizimin ose rifinancimin e portofolit të kredive;
 - 5.6.3. mbajtjen, rifinancimin, shitjen ose rikthimin e letrave me vlerë përkatëse;
- 5.7. lidh kontrata dhe marrëveshje me subjekte publike dhe private për përmbushjen e funksioneve të veprimtarisë së tij;
- 5.8. merr shërbime këshilluese e teknike të lidhura me përmbushjen e funksioneve të veprimtarisë së tij.
6. Për përmbushjen e veprimtarisë së tij, Subjekti mund t'i ushtrojë funksionet e përcaktuara në këtë nen:
 - 6.1. në mënyrë të pavarur ose në bashkëpunim me institucionet e nevojshme për zbatimin e detyrave përkatëse;
 - 6.2. drejtpërdrejtë ose nëpërmjet një pale të tretë të kontraktuar për ofrimin e shërbimeve, në funksion të përmbushjes së veprimtarisë së Subjektit.

Neni 8

Strategjia dhe profili i rrezikut të Subjektit për menaxhimin e aseteve

1. Subjekti harton dhe dërgon për miratim nga BQK, si dhe zbaton strategjinë dhe profilin e rrezikut ndaj të cilit do të ekspozohet gjatë kryerjes së veprimtarisë së tij.
2. Strategjia dhe profili i rrezikut përmbajnë një përshkrim të rreziqeve më të rëndësishme, ndaj të cilave do të ekspozohet Subjekti, parimet mbi të cilat sigurohet menaxhimi dhe ndërmarrja e këtyre rreziqeve dhe/ose politikat dhe procedurat e menaxhimit të rrezikut, si dhe parashikimet për ushtrimin e funksioneve të kontrollit të brendshëm.
3. Në rast të ndryshimit të fakteve dhe të rrethanave mbi të cilat është hartuar strategjia e menaxhimit të rrezikut, Subjekti mund të ndryshojë profilin e rrezikut dhe strategjinë e menaxhimit të rrezikut, duke njoftuar paraprakisht BQK-në për këto ndryshime.
4. BQK miraton, ndryshon ose refuzon ndryshimet e propozuara, sipas paragrafit 3 të këtij neni.

Neni 9

Organet e udhëheqëse të Subjektit për menaxhim të aseteve

1. Subjekti organizohet, drejtohet dhe kryen veprimtarinë e tij nëpërmjet Bordit të Drejtorëve, Kryeshefit Ekzekutiv dhe personelit, siç përcaktohet në këtë rregullore.
2. Bordi i Drejtorëve ka këto kompetenca dhe detyra:
 - 2.1. garanton kryerjen me cilësi, në kohë dhe me efikasitet të funksioneve të Subjektit të përcaktuara në nenin 4 të kësaj rregullore;
 - 2.2. përcakton dhe përshtat planin strategjik dhe financiar të Subjektit, në përputhje me strategjinë e përmbylljes;
 - 2.3. përcakton objektivat strategjike të Subjektit, në përputhje me strategjinë e përmbylljes;
 - 2.4. siguron se ekzistojnë sistemet dhe procedurat e përshtatshme për të arritur objektivat strategjike dhe ndërmerr të gjithë hapat e nevojshëm për të arritur këto objektiva;
 - 2.5. drejton veprimtaritë me rëndësi të veçantë me palët e lidhura dhe ekspozimet e mëdha për asetet e transferuara;
 - 2.6. miraton politikën e menaxhimit të rrezikut, përfshirë vlerësimin e efikasitetit të sistemeve të brendshme të kontrollit si dhe përshtatshmërinë e praktikave organizative, administrative dhe të kontabilitetit;
 - 2.7. miraton politikat e brendshme të funksionimit të Subjektit;
 - 2.8. themelon komitete të brendshme, të nevojshme për përmbushjen e objektivave të Subjektit;
 - 2.9. siguron që pasqyrat financiare të Subjektit të auditohen jo më pak se 1 herë në vit nga një auditor i jashtëm i licencuar;
 - 2.10. siguron se pasqyrave financiare përpilohen dhe auditohen në bazë të standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit;
 - 2.11. mbikëqyrë procesin e informimit dhe të marrëdhënieve të komunikimit me publikun mbi procesin e menaxhimit të aseteve të transferuara.
3. Funksionet e Kryeshefit Ekzekutiv të Subjektit janë:
 - 3.1. vepron në emër të Subjektit dhe përfaqëson interesat e tij;
 - 3.2. menaxhon Subjektin dhe siguron përmbushjen e vendimeve të Bordit të Drejtorëve të Subjektit;
 - 3.3. emëron punonjësit e Subjektit.

Neni 10

Kriteret për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit të Drejtorëve

1. Bordi i Drejtorëve i subjektit përbëhet nga 3 anëtarë, përfshirë këtu edhe Kryeshefin Ekzekutiv.
2. Në varësi të strukturës së pronësisë të Subjektit, BQK emëron ose miraton anëtarët e Bordit të Drejtorëve të Subjektit dhe Kryeshefin Ekzekutiv për një afat 3 vjeçar me të drejtë rizgjedhjeje.

3. Bordi i Drejtorëve si tërësi duhet të posedoj njohuri adekuate, aftësi dhe përvojë të mjaftueshme të përshtatshme me veprimtarinë e Subjektit. Kandidatët për anëtarë të Bordit të Drejtorëve duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:
 - 3.1. posedon diplomë universitare në ekonomi apo jurisprudencë, ose studime të ngjashme, ose të posedojë njohuri dhe përvojë adekuate se paku 3 vjeçare në sektor financiar në fushat që lidhen me menaxhim të aseteve financiare, ristrukturime dhe likuidime, vlerësim të bankave, menaxhim të rrezikut, financa ose auditim;
 - 3.2. të mos ketë asnjë konflikt interesi aktual, potencial ose të perceptuar që mund të cenojë kryerjen me objektivitet dhe të pavarur të detyrave të saj/tij. Në veçanti:
 - 3.2.1. nuk është i punësuar, pronar, bashkëpronar ose drejtor apo menaxher i lartë në banka të licencuara, me seli në Republikën e Kosovës;
 - 3.2.2. nuk ka raport në aspekt të punësimit, biznesit, financiar apo personal me bankën në proces të përmbylljes, institucionin urë, pranuesin, aksionarin kryesor ose kreditorin e bankës, vlerësuesin, apo ofruesin e shërbimeve apo ndonjë aksionar që mund të krijojë konfliktin e interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
 - 3.3. nuk është dënuar nga gjykata për vepra penale;
 - 3.4. nuk është subjekt i hetimeve për vepra penale;
 - 3.5. nuk është i përfshirë ose i lidhur me humbje financiare të shkaktuara nga veprimet e pandershme, të papërgjegjshme ose neglizhente, në lidhje me kryerjen e shërbimeve financiare dhe menaxhimin e subjekteve ose institucioneve të tjera.
4. Anëtarët e Bordit të Drejtorëve dhe Kryeshefi Ekzekutiv duhet të përmbushin kriteret të përcaktuara në këtë nen, gjatë gjithë kohës sa janë në detyrë. Ata duhet ta njoftojnë, pa vonesë, BQK-në për çdo rrethanë që mund të ndikojë në përshtatshmërinë e tyre. BQK mund të kërkojë trajnime shtesë, të vendosë masa që zvogëlojnë rrezikun ose të shkarkojë dhe të zëvendësojë një anëtar, kur kërkesat e këtij neni nuk përmbushen më.

Neni 11

Menaxhimi i Subjektit për menaxhimin e aseteve

1. Në çdo rast, në pajtim me kornizën ligjore dhe rregullative dhe në përputhje me statutin e Subjektit, Bordi i Drejtorëve dhe Kryeshefi Ekzekutiv i Subjektit duhet të bashkëpunojnë me BQK-në, në pajtueshmëri me strategjinë e përmbylljes.
2. Brenda 3 muajve nga data e themelimit të Subjektit, Bordi i Drejtorëve miraton aktet e mëposhtme:
 - 2.1. kodin e etikës dhe rregulloret e brendshme për të punësuarit e Subjektit;
 - 2.2. standardet dhe procedurat për trajtimin e aseteve të transferuara, në përputhje me natyrën e tyre dhe kuadrit rregullator dhe kontabël në fuqi;
 - 2.3. praktikat e menaxhimit të rrezikut, në përputhje me përmbushjen e objektivave dhe qëllimeve të veprimtarisë së Subjektit dhe të profilit të portofolit të aseteve të transferuara;
 - 2.4. mënyrën e likuidimit/shitjes së aseteve të transferuara dhe procedurat përkatëse për menaxhimin e këtij procesi.

3. Bordi i Drejtorëve, jo më vonë se 3 muaj nga data e krijimit të Subjektit, miraton krijimin e se paku 2 komiteteve dhe emëron anëtarët përkatës të Bordit të Drejtorëve që do të drejtojnë secilin komitet, si në vijim:
 - 3.1. komitetin e auditimit;
 - 3.2. komitetin e menaxhimit të rrezikut.

Neni 12

Marrëdhëniet kontraktuale për shërbimet e ofruara nga palët e treta

1. Me qëllim përmbushjen e objektivave të veprimtarisë, Subjekti mund të nënkontraktojë shërbime të ofruara nga palë të treta, në lidhje me menaxhimin, shitjen dhe likuidimin e aseteve të transferuara.
2. Në kontratën e nënshkruar për shërbime të ofruara nga palët e treta, Subjekti duhet të sigurohet se kjo palë:
 - 2.1. vepron në përputhje me standardet më të larta të etikës dhe ofron të gjitha shërbimet e duhura teknike në kryerjen e aktivitetit të saj, sipas mandatit të dhënë për të promovuar interesat më të mira të Subjektit;
 - 2.2. vendos në dispozicion burimet dhe procedurat e nevojshme për kryerjen me cilësi të shërbimit të ofruar;
 - 2.3. ndërmerr çdo përpjekje të nevojshme për të parandaluar ose menaxhuar konfliktin e interesit dhe për të deklaruar nëse ka ndonjë konflikt të tillë (aktual ose potencial) pranë Subjektit;
 - 2.4. përmbush të gjitha obligimet rregullative ndaj të cilave është subjekt;
 - 2.5. bashkëpunon me Subjektin në procesin e certifikimit të pozicionit financiar të portofolit të aseteve, për atë që lidhet me shërbimin e ofruar ndaj Subjektit.

Neni 13

Llogaritë dhe regjistrat financiarë të Subjektit për menaxhimin e aseteve

1. Subjekti mban llogaritë, regjistrimet dhe përgatit pasqyrat financiare, me qëllim që në çdo kohë të pasqyrohet qartë dhe saktë pozicioni financiar i Subjektit, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me standardet ndërkombëtare për raportimin financiar.
2. Në zbatim të paragrafit 1 të këtij neni, llogaritë dhe regjistrimet të Subjektit identifikojnë në mënyrë të qartë:
 - 2.1. fondet e transferuara për krijimin e Subjektit;
 - 2.2. kostot e menaxhimit dhe shpenzimet e Subjektit për kryerjen e veprimtarisë së tij;
 - 2.3. listën e portofolit të aseteve, të drejtave ose detyrimeve të transferuara dhe vlerën e vlerësimit të bërë për çdo portofol;
 - 2.4. listën e garancive (nëse ka) në mbështetje të aseteve të transferuara;
 - 2.5. çdo informacion tjetër të nevojshëm të komunikuar nga BQK.

3. Shpenzimet e Subjektit gjatë kryerjes së aktivitetit të tij mbulohen nga mjetet financiare në dispozicion të Subjektit të cilat përbëhen nga:
 - 3.1. fondet e transferuara për krijimin e Subjektit;
 - 3.2. të ardhurat nga menaxhimi i aseteve të transferuara;
4. Në zbatim të paragrafit 1 të këtij neni, Subjekti miraton, dokumenton dhe zbaton të gjitha politikat, procedurat dhe sistemet mbështetëse të nevojshëm për evidentimin e detajuar dhe të plotë, regjistrimin, vlerësimin, menaxhimin, raportimin dhe shitjen e aseteve, të drejtave ose detyrimeve të transferuara.

Neni 14

Raportimi

1. Subjekti duhet të raportojë në BQK, në baza tre mujore, lidhur me aktivitetin e tij.
2. Raportimi tremujor përfshin informacion mbi tremujorin përkatës, në lidhje me:
 - 2.1. numrin dhe vlerën e kredive në portofol dhe gjendjen e tyre të kategorizuar si performuese dhe kredi me probleme;
 - 2.2. kategorizimi i kredive me probleme sipas klasifikimit të rrezikut kreditor;
 - 2.3. numrin dhe vlerën e kredive të shlyera;
 - 2.4. palët e treta të kontraktuara për trajtimin e kredive përkatëse sipas portofolit;
 - 2.5. një listë të të gjitha çështjeve ligjore mbi aktivet e transferuara duke përcaktuar:
 - 2.5.1. objektin në shqyrtim
 - 2.5.2. palët e përfshira në proces
 - 2.5.3. qëndrimin e Subjektit mbi procesin
 - 2.6. raport të detajuar i të hyrave të marra sipas portofolit, si dhe i të hyrave të arkëtueshme;
 - 2.7. shumën e rimarrë nga shitja e aseteve në portofol;
 - 2.8. të hyrat të tjera të marra nga interesi i kredisë të transferuar pranë Subjektit;
 - 2.9. bilancin financiar të aseteve dhe detyrimeve të Subjektit;
 - 2.10. rezultatin financiar dhe pasqyrën financiare të të hyrave dhe shpenzimeve të Subjektit.
3. BQK mund të kërkojë nga Subjekti raportime shtesë, sipas formatit dhe frekuencës së nevojshme, në lidhje me:
 - 3.1. përmbushjen e objektivave të Subjektit;
 - 3.2. çdo informacion apo statistikë të nevojshme për vlerësimin e performancës së Subjektit në kryerjen e funksionit të tij.

Neni 15

Mbikëqyrja dhe kontrolli i Subjektit për menaxhim të aseteve

1. Subjekti respekton kërkesat ligjore dhe nënligjore në fuqi, në lidhje me ushtrimin e veprimtarive të përcaktuara në vendimin e themelimit të tij dhe/ose vendimin sipas ndryshimeve të mëvonshme.

2. BQK mbikëqyrë dhe kontrollon veprimtarinë e Subjektit, në përputhje me kërkesat e Ligjit për Bankat dhe të akteve nënligjore të nxjerra nga BQK.
3. BQK, në rast se konstaton që Kryeshefi Ekzekutiv ose anëtarët e Bordit të Drejtorëve nuk veprojnë në përputhje me interesat dhe objektivat e përcaktuara, ka të drejtë të marrë masa ose të vendosë sanksione që i gjykon të nevojshme, në përputhje me dispozitat e Ligjit për Bankat si dhe të kornizës rregullative të aplikueshme në zbatim të këtij Ligji.

Neni 16

Përfundimi i aktivitetit të Subjektit për menaxhim të aseteve

1. BQK vendosë për përfundimin e aktivitetit të Subjektit, kur plotësohet të paktën një nga kushtet e mëposhtme:
 - 1.1. të gjitha asetet, të drejtat dhe detyrimet e transferuara pranë Subjektit i janë shitur një pale të tretë ose janë likuiduar;
 - 1.2. Subjekti nuk plotëson më kërkesat dhe objektivat për të cilat është krijuar;
 - 1.3. përfundon afati i përcaktuar në vendimin për themelimin e Subjektit.

Neni 17

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas miratimit nga Bordi i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës.

Dr. Sc. Bashkim Nurboja

Kryetar i Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës